



**Qendra Shqiptare për Popullsinë
dhe Zhvillimin**

RAPORTI VJETOR 2016

Tiranë, 2017

Lista e programeve dhe aktiviteteve

- *Qasja dhe Përdorimi i Shërbimeve të Shëndetit Riprodhues dhe Seksual nga gratë në moshën e riprodhimit - (financuar nga IPPF)*
- *Hapja e rrugës në favor të cilësisë së SHSR për të rinjtë – (financuar nga) IPPF 5*
- *Aborti i pasigurtë është vetëm një histori – (financuar nga) IPPF*
- *Ne jemi të Rinjtë me Zgjedhje – (financuar nga) IPPF*
- *Integrimi i MISP brenda platformës kombëtare në situatë emergjence – (financuar nga) UNFPA*
- *Fushata për seksin mbi bazë përzgjedhje – (financuar nga) UNFPA*
- *Gratë dhe vajzat e zonave rurale, faktorë ndryshimi në komunitet – (financuar nga) Olof Palme International Center*
- *Burrat dhe djemtë, kampionë të barazisë gjinore (Selenica dhe Orikum) – (financuar nga) UNFPA*
- *Vërtetë të barabartë – (financuar nga) IPPF Branch*
- *Udhëzimet dhe protokollat mbi Shërbimet Miqësore me të Rinjtë – (financuar nga) UNFPA*
- *Raporti Hije CEDAW*
- *Programet e rritjes së kapaciteteve të të rinjëve në SHSR – (financuar nga) UNFPA*
- *Planifikimi Familjar – (financuar nga) UNFPA*
- *Përmirësimi i Cilësisë së Kujdesit për shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe Zbatimi i iniciativës BTN – (financuar nga) UNFPA*
- *Integrimi i SHSR dhe ICPD në prioritetet kombëtare të Agjendës së 2030 – (financuar nga) UNFPA*
- *Kanceri i qafës së mitrës – (financuar nga) UNFPA*
- *Parandalimi dhe kontrolli i kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri – (financuar nga) IPPF*
- *Për një qasje ndaj HIV dhe SIDA pa stigma, të ndjeshme ndaj gjinisë për popullatat kyçe – (financuar nga) IPPF*
- *Të rritet përkushtimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian për t'u dhënë zë nevojave të tyre*
- *Buxheti*

Titulli: Qasja dhe Përdorimi i Shërbimeve të Shëndetit Riprodhues dhe Seksual nga gratë në moshën e riprodhimit - (financuar nga IPPF)

❖ Objektivat

1. Përmirësimi i qasjes dhe shërbimeve të SHSR nga gratë e moshës së riprodhimit.
2. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë të qendrave shëndetësore parësore në zonat rurale të Tiranës dhe Vlorës.

➤ Rezultatet:

- ✓ 29625 shërbime në total janë ofruar falas për komunitetin Rom, të varfërit, punonjëset e seksit dhe gratë e dhunuara, të rinjtë jashtë shkolle, gratë që jetojnë në zona rurale etj. Duke iu siguruar cilësi dhe standarte nga stafi mjekësor dhe programatik të trainuar.
- ✓ QSHPZH ka organizuar 4 klinika të lëvizshme me 60 gra të reja të zonave rurale të Tiranës (Shengjergj dhe Zall-Bastar).
- ✓ Ka organizuar 4 takime në komunitet me pjesëmarrjen e 80 grave dhe vajzave që jetojnë në zonat rurale të Tiranës mbi tema si: gjinia dhe të drejtat; IST/HIV/AIDS; marrëdhëniet; komunikimi dhe vendim-marrja; trupi dhe puberteti; seksi pozitiv etj.
- ✓ 40 punonjës shëndetësor të qendrave shëndetësore të zonave rurale të Tiranës u trainuan mbi udhëzuesin dhe protokollin e planifikimit familjar duke rritur njohuritë dhe kapacitetet në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuan aftësitë e tyre në punën me të rinjtë lidhur me shëndetin riprodhues dhe seksual.



Titulli: Hapja e rrugës në favor të cilësisë së SHSR për të rinjtë – (financuar nga) IPPF

❖ Objektivi

Përmirësimi i angazhimit në nivel qendror i aprovimit të udhëzuesve për komponentët e shëndetit rinor deri në fund të vitit 2016.

➤ Rezultatet:

- ✓ Ministria e Shëndetësisë miratoi udhëzuesin për shërbimet miqësore dhe shëndetin riprodhues dhe të drejtat.
- ✓ 6 fokus grupe janë organizuar në Kukës, Korçë, Elbasan, Tiranë dhe Vlorë me pjesëmarrjen e 90 të rinjve të moshës 15 – 24 vjeç.
- ✓ 1000 kopje të broshurës “Shërbimet Miqësore për të Rinjtë” me çështje seksin dhe seksualitetin për të dy individët – aktivë dhe jo aktivë seksualisht u publikuan nga stafi i QSHZPH dhe u shpërndanë gjatë implementimit të aktiviteteve në kuadër të projektit.



Titulli: Aborti i pasigurtë është vetëm një histori – (financuar nga) IPPF

❖ Objektivat

1. Të përmirësojmë kujdesin ndaj abortit nëpërmjet paraqitjes dhe zbatimit të Udhëzuesit të Abortit të Sigurt (IPPF dhe ëHO) në sistemin shëndetësor në Shqipëri deri në 2018.
2. Të rrisim ndërgjegjësimin në publik mbi Abortin e sigurt deri në 2018.
3. Të sigurojmë akses me bazë të drejtat, të sigurt klinikisht dhe shërbime aborti të përshtatshme për gratë në klinikat e ACPD deri në 2018.

➤ Rezultatet:

- ✓ Dy seminare një ditore u organizuan me 40 pjesëmarrës të personelit shëndetësor të qendrave shëndetësore parësore në Pogradec dhe Durrës.
- ✓ Në ditën ndërkombëtre të Abortit, stafi i QSHPZH së bashku me organizatat partnere organizuan një fushatë për rritjen e ndërgjegjësimit. Të rinjtë kishin në duar balona dhe veshën bluza me mesazhe rreth stigmës ndaj abortit.
- ✓ Në ditën ndërkombëtre të Abortit, stafi i QSHPZH, organizoi një ditë të hapur në klinikën e Tiranës dhe Vlorës për të ofruar shërbime falas. 40 gra të reja erdhën në klinikë për të marrë shërbime të shëndetit iprodhues dhe seksual. 200 prezervativë, 250 teste shtatzënie dhe 50 kontracetivë emergjence iu shpërndanë klinetëve që vizituan klinikat tona.
- ✓ Stafi mjekësor i QSHPZH ka ofruar shërbime të abortit në klinikat e Tiranës dhe Vlorës me qëllim që të uli sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë nga aborti i pasigurtë. 205 shërbime të kujdesit pas abortit iu ofruan grave të reja që vizituan klinikat tona.



Titulli: Ne jemi të Rinjtë me Zgjedhje – (financuar nga) IPPF

❖ Objektivi

Të përmirësojmë shëndetin riprodhues dhe seksual të djemve dhe vajzave që jetojnë në zonat rurale të Tiranës përmes avancimit të sjelljes së individit deri në fund të vitit 2016.

➤ Rezultatet:

- ✓ Pesë seminare një ditore janë organizuar nga stafi i QSHPZH me pjesëmarrjen e 60 djemve të rinj, vajzave të reja, djemve të rritur, vajzave të rritura në zonat rurale të Tiranës, mbi shëndetin riprodhues dhe seksual dhe gjininë me qëllim që të ndryshojnë sjelljen dhe komunikimin e tyre.
- ✓ 40 ofrues shërbimi nga QSHPZH, organizata të tjera, mjekë të shkollave, mjekë të qendrave shëndetësore parësore janë trajnuar për ofrimin e shërbimeve gjinore miqësore.
- ✓ 40 të rinj vajza dhe djem morrën pjesë në sesionet edukuese në grup gjatë të cilave morrën njohuri dhe informacion mbi normat gjinore.



Titulli: Integrimi i MISP brenda platformës kombëtare në situatë emergjente – (financuar nga) UNFPA

➤ Rezultate

- ✓ Në kuadër të projektit të UNFPA, stafi i SHPZH ka organizuar tre trainime 3 ditore me pjesëmarrjen e 60 punonjësve të shëndetësisë në qendrat shëndetësore parësore dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik të rretheve Korçë, Gjirokastër dhe Sarandë me qëllimin për ti pajisur me njohuri dhe aftësi për të qenë të përgatitur përballë situatave emergjente.



Titulli: Fushata për seksin mbi bazë përzgjedhje – (financuar nga) UNFPA

❖ Objektivi

Të ndikojmë në rënien e dikriminimit gjinor dhe shprehjen e vlerave mashkullore mbi abortin me bazë përzgjedhje të gjinisë si një mjet advokues.

➤ Rezultatet

- ✓ 120 të rinj të moshës 15-25 morrën pjesë në 6 seminare një ditore (2 seminare për secilin qytet, Tirana, Vlora, Fieri) me qëllimin për ti informuar ata mbi pasojat e abortit me bazë përzgjedhje ndaj gjinisë dhe në përgjegjshmërinë e adresimit të mentalitetit patriarkal që çon në diskriminimin e vajzave.



**Titulli: Gratë dhe vajzat e zonave rurale, faktorë ndryshimi në komunitet – (financuar nga)
Olof Palme International Center**

❖ Objektivat

1. Këshillat e pushtetit vendor dhe zyrtarët e bashkisë i pergjigjen gjithnjë e më mirë nevojave të qytetarëve veçanërisht grupeve të marxhinalizuara.
2. Fuqizimi i qytetareve vecanerisht grave dhe vajzave te advokojne per barazi gjinore dhe te sigurojne qeverisje te pergjigjshme dhe efektive.
3. Forcim i bashkëpunimit midis OJF-ve, grupeve të tjera të interesit dhe komunitetit në mbeshtetje të nevojave të nënperfaqësuarve.

➤ Rezultate

- ✓ 50 gra anëtare të Forumeve të Pavarura të Grave, kanë monitoruar 10 mbledhje të Këshillit Bashkiak Vlorë duke bërë advokasi përmes Aleancës së Grave Këshilltare.
- ✓ Është mundësuar transporti falas për gratë/vajzat në nevojë të zonave rurale, për të marrë pjesë në kurset profesionale në qytet.
- ✓ Aleanca e Grave anëtare të Këshillit Bashkiak Vlorë është ndërgjegjësuar lidhur me nevojat e grupeve të marxhinalizuara duke përfshirë edhe romët dhe egjptianët.
- ✓ Pesë takime konsultime janë organizuar nga Bashkia Vlorë për të mbledhur prioritetet për hartimin e buxhetit për 2017-ën.
- ✓ Është ngritur për herë të parë Forumi i Pavarur i Grave të Shushicës me 25 qytetarë.
- ✓ Katër letra zyrtare janë dërguar tek pushteti vendor mbi nevojat që duhen adresuar me buxhetin e 2017-ës.
- ✓ 47 qytetarë nga Shushica janë ndërgjegjësuar mbi barazinë gjinore dhe ligjet për të drejtat e njeriut.
- ✓ 75 gra dhe vajza kanë marrë pjesë në Panairin e Orikumit duke ekspozuar ambientet e turizmit familiar, gatimet, punimet e dorës dhe produktet bio.
- ✓ 20 përfaqësues të partive politike përmes 6 takimeve janë ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në politikë dhe vendimarrje.

- ✓ Afro 21 përfaqësues të OJF-ve dhe institucioneve partnere janë intervistuar në media në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit.
- ✓ Afro 18000 njerëz kanë ndjekur tre transmetimet Televizive në mbrojtje të të drejtave të grave si dhe dokumentarin “Gratë, faktorë ndryshimi”.
- ✓ Pesë nga 10 prioritetet e kontratës Sociale janë përfshirë në Buxhetin e Bashkise Vlorë për vitin 2017.



**Titulli: Burrat dhe djemtë, kampionë të barazisë gjinore (Selenica dhe Orikum) –
(financuar nga) UNFPA**

❖ **Objektivat**

1. Kampionët meshkuj për barazi kanë fituar aftësitë e duhura për të ndërtuar një sistem vlerash që promovon barazinë dhe aleancën midis burrave dhe grave në familje dhe shoqëri si dhe duke sfiduar stereotipet gjinore në zonat e projektit.
2. Ndërgjegjësim midis burrave dhe djemve të zonave të projektit, sesi pabarazia gjinore, dhuna me bazë gjinore ndikon tek komuniteti dhe familja.

➤ **Rezultate**

- ✓ 61 (19F; 42M) të rinj nga shkolla e mesme në Selenice dhe Orikum janë përfshirë aktivisht në fushatat e përmuajshme.
- ✓ 42 djem dhe burra janë përfshirë aktivisht në aktivitete të projektit dhe kjo është arritur duke patur parasysh mentalitetin patriarkal të zonës.
- ✓ 250 të rinj marshuan në rrugët e Orikumit dhe Selenicës në mbështetje të të drejtave të grave kundër dhunës me bazë gjinore.
- ✓ 700 (380M, 320F) të rinj nga shkolla të mesme të Orikumit dhe Selenicës dhe të Vlorës janë ndërgjegjësuar përmes teatrit “Kur mungon fjala”.
- ✓ 4500 njerëz (nga të gjitha grupmoshat) janë arritur me mesazhe kundër dhunës me bazë gjinore dhe materiale promovuese, me rastin e fushatave të ndërgjegjësimit të “Ditëve Portokalli”.
- ✓ Dy raste të dhunës me bazë gjinore janë raportuar në polici, duke shënuar kështu edhe dy rastet e para të denoncimit të dhunës në familje për komunitete kaq patriarkale dhe të mbyllura.
- ✓ Gjatë “Ditëve Portokalli” në Orikum, gjatë muajve të verës, turistët i janë bashkuar grupit të vullnetarëve për të rritur ndërgjegjësimin.
- ✓ Është rritur besimi i komunitetit tek grupi COMBAT i aktivistëve të rinj.
- ✓ Konferenca ndihmoi të dy komunitetet e Orikumit dhe Selenicës të ndajnë me njëri tjetrin arritjet dhe sfidat.



Titulli: Vërtetë të barabartë – (financuar nga) IPPF Branch

❖ Objektivat

1. Të rriten kapacitetet e ofruesve të shërbimeve, drejtuesve të komunitetit dhe aktivistëve të shoqërisë civile për të kuptuar dhe adresuar sic duhet Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ) dhe dhunën në Familje (DHF).
2. Të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit dhe njohuritë mbi Dhunën me Bazë Gjinore dhe impaktin e saj në shëndetin riprodhues midis grave dhe të rinjve që janë grupi më vulnerabël, për të siguruar aksesin e tyre ndaj shërbimeve efektive dhe të sigurta.
3. Të forcojmë strukturat dhe kapacitetet e të rinjve për të adresuar Dhunën me Bazë Gjinore.

➤ Rezultate

- ✓ Komuniteti është ndërgjegjësuar mbi objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe veçanërisht objektivin numër 5 të lidhur me DHBGJ përmes fushatave të vazhdueshme të ndërgjegjësimit dhe komunikimeve për shtyp.
- ✓ Qendra Aulona është tashmë pjesë e Mekanizmit të Referimit kundër DHBGJ për rrethin e Vlorës.
- ✓ 25 ofrues Shërbimesh kanë fituar informacion lidhur me DHBGJ dhe DHF dhe mekanizmin respektiv të referimit.
- ✓ 96 persona (40M, 44F) nga komuniteti Rom i Novoseles janë ndërgjegjësuar mbi të drejtat e grave, DHBGJ, DHF, dhe pasojat e saj në familje dhe në shëndetin e gruas.
- ✓ Shfaqja teatrale ishte një mjet i suksesshëm për të rritur ndërgjegjësimin e 500 personave, (të rinj dhe drejtues të komunitetit) mbi barazinë gjinore, DHBGJ dhe kundër martesave të hereshme dhe të detyruara.
- ✓ 3000 fletëpalosje janë prodhuar dhe shpërndarë për të advokuar kundër pabarazive gjinore, kundër DHBGJ dhe DHF.
- ✓ Partneriteti dhe rrjetëzimet që ACPD ka vendosur me shume aktorë dhe OSHC ndikoi për zbatimin me sukses të aktiviteteve të projektit.
- ✓ Në shumë fushata ndërgjegjësimit dhe aktivitete edukative ACPD ka promovuar projektin dhe qëllimin e tij për të kontribuar për parandalimin e Dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Shqipëri. Çdo aktivitet i projektit është raportuar në kohë reale përmes postimeve të dedikuara në mediat sociale si dhe në faqen eeb të organizatës.



Titulli: Udhëzimet dhe protokollet mbi Shërbimet Miqësore Rinore

❖ Objektivat

1. Të ofrojë informacion, udhëzime dhe këshilla praktike "për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e adoleshenteve" duke promovuar praktika të shëndetshme, të suksesshme, bashkëkohore, të cilat sigurojnë rritjen, zhvillimin normal, promovimin e sjelljeve të shëndetshme dhe ofrojnë mundësi për të parandaluar probleme të ndryshme që mund të ndodhin gjatë rritjes dhe zhvillimit në adoleshencë.

➤ Rezultatet

- ✓ Hartimi i Standardeve të Shërbimeve Miqësore Rinore
- ✓ Hartimi i Udhëzimeve të Shërbimeve Miqësore Rinore
- ✓ Hartimi i tre protokolleve të Shërbimeve Miqësore Rinore
- ✓ Akreditimi i tri dokumenteve dhe miratimi i protokolleve me urdhër nga Ministri i Shëndetësisë.

Titulli: Raporti Hije CEDAW

- Takimi për **promovimin e publikimit të raportit Hije**, Fusha e Kujdesit Shëndetësor – **Rasti i Shqipërisë** (7 Prill 2016)

Kishte pjesëmarrës nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, IPH, stafi i UNFPA-së dhe OJQ-të. ACPD prezantoi çështjet kryesore të përfshira në raportin Hije, të cilat i janë dërguar Komitetit të CEDAW, hartuar nga 21 OJQ. Pjesëmarrësit bënë sugjerime për përmirësimin e raportit Hije.

- **Rezultatet**

- ✓ Hartimi i raporteve Hije, si një ndërmarrje e 21 OJQ-ve provoi të jetë shumë efektiv dhe të merret në konsideratë nga ana e Komitetit të CEDAW dhe gjithashtu është referuar edhe në një numër të fjalimeve dhe prezantimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✓ Përveç pyetësorit i cili u plotësuar nga OJQ-të, ishin shumë të dobishme edhe intervistat me zyrtarët qeveritarë, specialistë të fushës.
- ✓ Procesi i hartimit të raporteve Hije duhet të kalojnë në një shqyrtimit të materialit në faza të ndryshme me pjesëmarrësit e OJQ-ve që kontribuan në përmbajtjen e tij. Pra, është e nevojshme që të organizohen takime konsultative për të marrë feedback prej tyre.
- ✓ Gjithashtu është shumë i dobishëm organizimi i seancave ku pjesëmarrësit të informohen mbi procedurat e raportit Hije të paraqitura ndaj Komitetit CEDAW, përfaqësuesit e OJQ-së kanë mundësinë t'i japin deklaratat e tyre me gojë përballë Komitetit një ditë para se raporti i qeverisë të shqyrtohet nga komisionerët.

**Titulli: Programet e rritjes së kapaciteteve të të rinjëve në SHSR – (financuar nga)
UNFPA**

❖ **Objektivi**

Rritja e aksesit në shërbimet cilësore të SHSR-ve, për të rinjtë dhe adoleshentët.

➤ **Rezultatet:**

- ✓ 120 (57M; 63F) të rinj nga Tirana dhe Vlora përftuan njohuri lidhur me shërbimet e Shendetit Seksual Riprodhues miqësore për të rinjtë.
- ✓ 30 (18M; 12F) prej tyre janë bërë pjesë e aktiviteteteve të organizuara nga QSHPZH dhe kanë raportuar se kanë ndarë me stafin dhe bashkëmoshatarët mësimet e marra.
- ✓ 150 (70M; 80F) të rinj u përfshinë në Ditën Botërore të Popullsisë, Ditën ndërkombëtare të Rinisë dhe Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe përcollën mesazhe të lidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, fuqizimin e grave, cuarjen përpara të SHSR, vullnetarizmin etj.
- ✓ Teste të shpejta të HIV iu ofruan përfaqësuesve të popullatave kyce: përdoruesve të drogës me injeksion, meshkujve që kryejnë seks me meshkuj, LGBT-ve, punonjësve të seksit – 19 persona (17M; 2F).
- ✓ 17 (7M; 10 F) të rinj me përvojë të ndryshme jetësore morën pjesë në një takim më bashkinë e Shkodrës. kryetarja e bashkisë u angazhua se do të punojë për realizimin e prioriteteve të të rinjve duke vënë theksin tek ndërhyrjet ndër-sektoriale.
- ✓ 70 (36 M; 34 F) të rinj morën pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e Ditës së Rinisë në Shkodër dhe përcollën mesazhin për politika që u mundësojnë të ërinjve një akses më të mirë në shërbime vecanërisht vajzave adoleshente.
- ✓ 7000 persona (moshat të reja) u arritën me mesazhe të SHSR, të avancimit të SHSR, fuqizimit të grave përmes edukimit dhe politikave konkrete me rastin e ditëve ndërkombëtare.



Titulli: Planifikimi Familjar – (financuar nga) UNFPA

❖ Objektivat

1. Zhvillimi i paketës së trajnimit bazuar në protokollet dhe udhëzimet e PF, të miratuara në vitin 2015.
2. Zhvillimi i materialeve ndihmëse të PF për ofruesit e PHC.
3. Finalizimi i platformës virtuale të të mësuarit dhe fillimi i implementimit të tij."

➤ Rezultatet

- ✓ U prodhuan edhe u shpërndanë, udhëzimet dhe protokollet për planifikimin familjar.
- ✓ Është përkthyer, përshtatur dhe publikuar "Mjeti vendimmarrës për klientët dhe ofruesit e planifikimit familjar".
- ✓ Zhvillimi i paketës TOT mbi "Trajnimin e planifikimit familjar për ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor".
- ✓ 33 pjesëmarrës janë certifikuar si trajnerë kombëtare, në fund të trajnimit TOT.

Në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Evropian Lindor për Shëndetin Riprodhues, platforma online Shqiptare u përshtat sipas standardeve dhe rregullave kombëtare të CME.

Titulli: Përmirësimi i Cilësisë së Kujdesit për shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe Zbatimi i iniciativës BTN – (financuar nga) UNFPA

❖ Objektivat

1. Të asistojë dhe të mbështesë spitalet e Durrësit, Shkodrës dhe Kukësit në implementimin e mjeteve të vetëvlerësimit përmes përdorimit të auditimeve klinike në spitalet përkatëse.
2. Të prezantojë iniciativën "Përtej numrave" dhe të ndërmerri një studim të "Rasteve Pranë Humbjes" në dy spitale të tjera rajonale.
3. Rishikoni / përditësoni Udhëzimet dhe Protokollet Kombëtare Klinike për Kujdesin Prenatal.

➤ Rezultatet

- ✓ Programi pilot i rishikimit të vizitave nga spitalet më të suksesshme të përmirësuara, tregoi se ndarja e përvojave të profesionistëve të tjerë të sektorit publik, të përballur me të njëjtat probleme të kujdesit, mund të përdoret në mënyrë më përfituese për të përmirësuar cilësinë e kujdesit për nënat dhe bebet e porsalindura.
- ✓ Ekipet në spitalet e përmirësuara kanë vazhduar me vlerësimin e cilësisë së kujdesit që spitalet ofrojnë për nënat dhe foshnjat e porsalindura duke analizuar dhe të dhënat e auditimit mbi rastet e nënave dhe të porsalindurve, dhe përvojën e tyre pozitive të qasjes së programit UNFPA që është duke ndihmuar për të përhapur procesin.
- ✓ Qasja e Ekipit multidisiplinar u pranuan nga drejtuesit e spitalit, si një model i mirë për të fokusuar të gjithë stafin e spitalit në përmirësimin e cilësisë së kujdesit në çdo nivel në mënyrë që të sigurojnë përmirësime të përgjithshme.
- ✓ Përfshirja e NCSQA si pjesë e ekipit që punon në ndërhyrjen për përmirësimin e cilësisë së kujdesit ka provuar të jetë një mësim i vlefshëm.

Titulli: Integrimi i SHSR dhe ICPD në prioritetet kombëtare të Agjendës së 2030

❖ Objektivi

Rritja e zotimeve të qeverisë dhe llogaridhënia për integrimin e çështjeve të SHSR-së dhe rezultateve të ICPD-së nga rezultatet e ICPD-së. Përtej rishikimit të 2014 brenda zbatimit kombëtar të axhendës së 2030 përmes aktiviteteve të avokimit në nivel kombëtar.

➤ Rezultatet

- ✓ Një ushtrim i planifikuar është hartuar dhe përfshin informacione mbi atë që institucionet qeveritare po bëjnë në lidhje me OZHQ-të, veçanërisht OZHQ 3 dhe 5.
- ✓ 20 përfaqësues të OJQ-ve për të Drejtat e Njeriut, morën pjesë në një workshop një ditor të titulluar "Si të avancojmë zbatimin e Agjendës 2030 dhe shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese".
- ✓ 2000 njerëz e kanë shikuar videon e prodhuar nga ACDP mbi OZHQ 3 dhe 5.
- ✓ 20000 njerëz u arritën në fushatat e rritjes së njohurive për **16 Ditë Aktivizmi, HIV/AIDS, Ditën e Popullsisë, Ditën e të Rinjëve me mesazhe dhe fjalime mbi OZHQ 3 dhe 5.**

Titulli: Kanceri i qafës së mitrës – (financuar nga) UNFPA

❖ Objektivat

1. Vlerësimi i nevojave për shërbimet e ekzaminimeve, kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe organizative si dhe sigurimi i përfshirjes së të gjithë aktorëve / niveleve të sistemit shëndetësor në zonën e Farkës në Tiranë dhe në qytetin e Fierit.
2. Trajnimi i profesionistëve të shëndetësisë, të cilët punojnë në zona të caktuara.
3. Mbështetja e qendrave shëndetësore lokale dhe drejtorive të shëndetit publik me të gjitha instrumentet e nevojshme për menaxhimin e organizuar të ekzaminimeve.
4. Ofrimi i ftesave të organizuara të grave në shënjestër.
5. Trajnimi i mjekëve dhe infermierëve në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor gjatë aktiviteteve të tyre të ekzaminimit.

➤ Rezultatet

- ✓ Rritja e aftësive të 92 profesionalistëve shëndetësor në Tiranë dhe Fier për çështje të tilla si informimi i grave, marrja / manipulimi i mostrave, referimi i rasteve pozitive dhe këshillimi.
- ✓ Janë organizuar në total 6 vizita në Fier dhe Libofshe (DSHP, Spitali, HC1 dhe HC Libofshe) dhe 5 vizita në qendrat shëndetësore të Farkës dhe Llundër.
- ✓ Më shumë se 500 gra janë kompletuar me ekzaminimet, dhe rezultatet laboratorike dhe formale të testeve.
- ✓ Më shumë se 65 gra janë dërguar për ekzaminime të mëtejshëm për të përfunduar diagnozat e një para kanceri potencial.

Titulli: Parandalimi dhe kontrolli i kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri – (financuar nga) IPPF

❖ Objektivat

1. Rritja e aksesit dhe përdorimi i shërbimeve cilësore të promovimit shëndetësor dhe shërbimeve të parandalimit të kancerit të qafës së mitrës të ofruara nga QSHPZH, sektori publik dhe privat.
2. Forcimi i njohurive dhe ndërgjegjësimit rreth parandalimit parësor dhe dytësor të kancerit të qafës së mitrës (metodat dhe rezultatet) tek gratë në moshë riprodhuese në Tiranë dhe Vlorë.
3. Promovimi i programeve të parandalimit dhe depistimit të shërbimin shëndetësor parësor të bazuara fakte me një mbulim rigoroz të grave të synuara dhe kontroll rigoroz në të gjitha nivelet për të përmirësuar politikat kombëtare të kancerit të qafës së mitrës.

➤ Rezultatet

- ✓ Trajnimi ToT në lidhje me "Parandalimin e kancerit të qafës së mitrës me anë të ekzaminimit, duke përdorur vlerësimin pamor me acid acetik si edhe trajtimin me krioterapi" u zhvillua duke përdorur materialet burimore të IPPF-së, përfshirë dy specialistë të SHSR.
- ✓ Një bërthamë ofrues shërbimi prej 20 personash (gjinekologë, mami, infermiere të kujdesit shëndetësor parësor dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile) u trajnuan mbi metodën e vlerësimit pamor me acid acetik (VIA) si edhe metodën e trajtimit me krioterapi.
- ✓ 18 marrëveshje bashkëpunimi u vendosën ndërmjet QSHPZH-së dhe Institutit të Shëndetit Publik, Drejtorive të Shëndetit Publik, Spitaleve dhe poliklinikave në Tiranë dhe Vlorë për të referuar klientët për diagnostikim të mëtejshëm dhe trajtim (analiza laboratorike, biopsi dhe **Leep**) dhe me organizatat e shoqërisë civile për të bashkëpunuar për çuarjen përpara të SHSR në vend në kuadër të projektit (edukim, avokasi dhe ndërgjegjësim etj.)
- ✓ 280 të rinj të moshës 9-13 u informuan për rrezikun dhe barrën e virusit të Papilomës Njerëzore (HPV) dhe kancerave të tjera të lidhura me të, për t'u mbrojtur përmes vaksinës HPV dhe metodave të tjera të depistimiti. 210 gra dhe burra nga zonat rurale dhe nga komuniteti rom përfituan njohuri rreth metodave të depistimit të kancerit të qafës së mitrës dhe rëndësisë së informacionit dhe depistimit për parandalimin e kancerit. Intervistat me klientë treguan se kishte klientë të cilët kishin marrë shërbime në klinikë pasi ishin informuar në sesionet edukuese.
- ✓ 1472 gra janë depistuar për kancerin e qafës së mitrës duke marrë shërbime nga klinikat lëvizëse apo në klinikat statike të QSHPZH. 80% e grave ishin depistuar për herë të parë.

- ✓ 13500 persona u arritën me mesazhe pozitive për depistimin e kancerit të qafës së mitrës dhe trajtimin si edhe për fuqizimin e grave që të bëjnë zgjedhjet e tyre shëndetësore përmes aktiviteteve edukuese dhe informuese dhe mediave sociale.
- ✓ Kjo nismë dhe projekti i UNFPA për kancerin e qafës së mitrës po plotësojnë njëra-tjetrën përmes depistimit të grave me pap smear dhe testin e HPV, duke kontribuar në shëndetin e grave dhe duke krijuar disa baza për disa praktika të mira për t'u ndarë me bashkëpunëtorët dhe qeverinë në 2017.
- ✓ Staf i QSHPZH dhe përfituesit (dy gra të përfshira në projekt) u angazhuan dhe përditësuan udhëzuesin klinik të QSHPZH-së duke shtuar komponentin e Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Praktikën e Standarteve Klinike dhe Guidën e Këshillimit të VIA, krioterapisë dhe testin HPV.
- ✓ Përgjatë janar-mars 2016, stafi i QSHPZH organizoi disa takime me bashkëpunëtorë nga Ministria e Shëndetësisë, UNFPA dhe organizata të shoqërisë civile dhe ofrues shërbimi ku u diskutua për planet e QSHPZH të lidhura me përfshirjen e teknologjive të reja në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës duke përfshirë VIA-n dhe krioterapinë që rezultuan në hasjen e një rezistence ndaj prezantimit të VIAs.
- ✓ Organizatat partnere të përquasura gjatë zbatimit të projektit dhe bashkëpunëtorë prej shumë kohësh të QSHPZH vazhdojnë të referojnë klientë tek shërbimet tek klinikat tona duke përfshirë grupet në nevojë, gra të reja që jetojnë në zonat rurale, gra të varfëra dhe gra të pamartuara.



Titulli: Për një qasje ndaj HIV dhe SIDA pa stigma, të ndjeshme ndaj gjinisë për popullatat kyçe

❖ Objektivat

1. Të sigurohet akses i barabartë në shërbimet e parandalimit, të trajtimit, kujdesit dhe mbështetjes të HV pa stigma, të ndjeshme ndaj gjinisë me fokus popullatën më të prekur (Meshkuj që kryejnë seks me meshkuj (MSM), Përdoruesit e drogës me injeksion (PËID), punonjëset e seksit (SË), njerëzit që jetojnë me HIV (PLHIV), të burgosurit dhe të tjerë grupe në nevojë që preken nga epidemia e HIV.
2. Rritja e angazhimit të komunitetit dhe efektiviteti në përmirësimin e shëndetit për popullatat kyçe.
3. Të sigurohet mbështetja e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj forcimit të sistemit shëndetësor që mundëson shërbime të integruara të HIV të bazuara tek nevojat dhe që janë kosto efektive

➤ Rezultatet

- ✓ 8 marrëvshje janë vendosur me organizata bashkëpunëtoare për të cuar përpara punën në kuadër të këtij projekti.
- ✓ 24 punonjës të shërbimit shëndetësor (mjekë familjeje, infermierë, teknikë laborator, dentistë dhe manaxherë të qendrave shëndetësore) u trajnuan sesi të ofrojnë shërbime të HIV pa stigma, të bazuara tek të drejtat dhe të ndjeshme ndaj gjinisë për popullatat kyçe.
- ✓ 2141 shërbime të HIV janë ofruar përmes klinikave statike (Tiranë dhe Vlorë) dhe atyre lëvizëse për personat në moshën 0-99 vjec duke përfshirë dhe popullatat kyçe.
- ✓ 30 persona që i përkasin grupeve MSM, SW, PWID bënë testin e shpejtë dhe konfidencial të ofruar nga QSHPZH përmes një klinike lëvizëse të organizuar në zyrat e Aksion+.
- ✓ Një seminar një ditor u mbajt më 16 qershor me 20 gazetarë dhe specialistë të komunikimit të mediave lokale dhe kombëtare tradicionale dhe sociale. 10 pjesëmarrës në vijim të trajnimit u angazhuan në 10 nismave të cilat përfshinë artikuj të shkruar, transmetime televizive dhe përdorimit të mediave sociale duke përdorur një gjuhë pozitive jo diskriminuese ndaj njerëzve që jetojnë me HIV apo popullatave kyçe të rrezikuara nga HIV e mediave sociale.
- ✓ Seminari "për një qasje të integruar ndaj HIV dhe SIDA tek popullatat kyçe" u zhvillua në Tiranë duke mbeldhur 20 zyrtarë nga ministria e shëndetësisë, mjekët, bashkëpunëtorë të shoqërisë civile dhe të rinj.
- ✓ Gjatë takime konsultuese për strategjinë e kontracepsionit, Strategjinë e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues, Udhëzuesi për Shërbimet Miqësore për të Rinjtë dhe një takim për kornizën strategjike të UNFPA 2017-2021 përfaqësues të MSH deklaruan se është

planifikuar të punohet për HIV dhe SIDA parandalim dhe trajtim përmes shërbimeve të edukimit, parandalimit dhe trajtimit të cilët do të përfshihen tek paketa e SHSR për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor.



Titulli: Të rritet përkushtimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian për t'u dhënë zë nevojave të tyre

❖ Objektivat

1. Të rriten njohuritë, aftësitë e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian për të përgatitur aktivistë, pjesëmarrës në vendim-marrjen dhe proceset e qeverisjes.
2. Të organizohet dhe mobilizohet komuniteti rom në zonat e përzgjedhura për të sjellë ndryshim në komunitet duke adresuar çështjet prioritare në buxhetet lokale.

➤ Rezultatet

- ✓ Gjatë takimeve përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian u informuan për rolin dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e minoriteteve ndaj thyerjes së ligjit dhe si të përcjellin një ankesë në rrugë ligjore.
- ✓ Në një Konferencë të zhvilluar në dhjetor nga Avokati i Popullit, Avokati i bëri thirrje qeverisë të marrin në konsideratë rekomandimet e tij lidhur me politikat e strehimit, regjistrin civile etj. Aktivistë të projektit morën pjesë në këtë konferencë në mbështetje të deklaratave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
- ✓ Së bashku përfaqësues të Avokatit të Popullit dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u angazhuan të mbështesin në cdo aktivitet ku ata do të marrin pjesë prioritetet e komunitetit rom dhe egjiptian.
- ✓ Si rezultat i trajnimit për avokasi, pjesëmarrësit kuptuan konceptin e avokasisë dhe elementët e saj; ata u informuan rreth institucioneve vendim-marrëse dhe ishin të aftë të identifikonin aktorët kryesorë që mund të mbështetnin fushatën e tyre të avokasisë; ata hartuan planet e tyre të avokasisë; u aftësuan si të identifikojnë partnerë për çështjet e tyre; zgjeruan njohuritë rreth rrugëve të bashkëpunimit duke përfshirë dhe komunikimin përmes medias.
- ✓ Lisat e prioritetëve të komunitetit rom dhe egjiptian u dorëzua në bashkinë e Vlorës, tek Departamenti i Kujdesit Social dhe Strehimit pranë bashkisë së Tiranës, si edhe tek Departamenti i Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Brendshme me qëllimin që të diskutohej mbi ato prioritete gjatë takimeve publike të zhvilluara në shkurt. përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian në Vlorë gjithashtu morën pjesë në një seancë dëgjimore me Aleancën e grave të këshillit bashkiak në nëntor 2016 me qëllimin për të ngritur zëtin e tyre për prioritetet e identifikuara. Si rezultat e punës avokuese një zë i vecantë buxheti është planifikuar për të mbuluar transportin e grave romë dhe egjiptiane nga zonat përreth të Vlorës, të cilat ndjekin kurset profesionale të ofruara nga Zyra e Punës (600 000 Leke). Për më tepër bashkia e Tiranës rriti buxheti për strehimin social për romët/egjiptianët në nevojë nga 3 000 000 Leke në 2016 në 4 000 000 Leke në 2017.



Fonde projektesh dhe të ardhura të realizuara gjatë vitit 2016

I. Nga Donatorët	(në 000/lekë)
IPPF	24,392 lekë
UNFPA	19,223 lekë
Olaf Palme	3,852 lekë
Save the Children	102 lekë
Ambasada Amerikane	968 lekë
II. Nga shërbime të tjera	
QSHPHZ	1,470 lekë

